



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0397

OSHP:2024/0397

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi - Kryetare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Sejdiu & Qerkini” Sh.P.K. kundër vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sherbimet e perfaqesimit ,avokatures dhe procedurave te ndermjetesimit” me numër të prokurimit 616-24-599-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, me datë 23.07.2024 mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “SEJDIU & QERKINI SH.P.K” me nr. 2024/397 , e datës 07.05.2024 lidhur me aktivitetin e “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit me numër të prokurimit 616-24-599-2-1-1" iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Administrata e Qendrës - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 01.02.2024 Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit me numër të prokurimit 616-24-599-2-1-1”. Ndërsa me datë 15.04.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomik PRO JURIS LAW FIRM L.L.C.; Tahiri & Partners SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 200,000.00 euro.

Me 22.04.2024 OE “SEJDIU & QERKINI SH.P.K” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 26.04.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 07.05.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “SEJDIU & QERKINI SH.P.K” me nr. 397/2024 lidhur me aktivitetin “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit me numër të prokurimit 616-24-599-2-1-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues SEJDIU & QERKINI SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : Me datën 27.02.2024 është publikuar Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, me të cilin dokument janë ndryshuar kriteret administrative për aplikim në këtë aktivitet të prokurimit. Nga kërkesa për dy referenca në lëndë të arbitrazhit vendor ose ndërkombëtar, kriteri është ulur në një referencë të arbitrazhit vendor apo ndërkombëtar dhe një referencë në shërbime të ngjashme gjyqësore. Tek përvoja e shoqërisë së avokatisë nga shtatë vite sa ishte fillimisht, kriteri është ulur në një vit përvojë dhe nga pesë avokat sa kërkoheshin fillimisht, kriteri është ulur në katër avokat të licencuar.

Pretendimi i dytë (II) : Me datën 11.03.2024 është bërë hapja e ofertave dhe leximi i çmimeve, me çka kemi kuptuar se në këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar përveç Ankuesit edhe dy oferta nga dy konsorciume të tjera, të cilat përbëhen nga një shoqëri e avokatisë dhe një shoqëri tregtare në formë të operatorit ekonomik që nuk është i regjistruar si shoqëri e avokatisë në përputhje me Nenin 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë. Me datë 15.04.2024 është publikuar Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me anë të së cilit kemi kuptuar se operator i rekomanduar për kontratë është grupi I operatorëve Pro Juris Law Firm LLC dhe Tahiri & Partners ShPK (tutje referuar si “operatori i rekomanduar”). Në anën tjetër si operator i dytë më i lirë është renditur grupi i Operatorëve Ekonomik Avokatura Istrefi SHPK dhe Avokat Jeton Osmani (biznes individual). Në anën tjetër oferta e Ankuesit është vlerësuar si e përgjegjshme,

por e pasuksesshme, pasi që për nga vlera e ofertës ishte më e lartë sesa dy ofertat e konsorciumeve të sipërcekura Duke marrë parasysh se me dosjen e tenderit është kërkuar që operatori të jetë vetëm shoqëri e avokatisë dhe në rast të angazhimit të kapaciteteve shtesë kjo të bëhet me kontratë për angazhim të avokatit nga shoqëria (kontratë punë), dy operatorët konkurrent, nuk e përmbushin këtë kusht të Dosjes së Tenderit, pasi që kanë aplikuar në konsorcium me operator që nuk janë shoqëri të avokatëve. Rrjedhimisht këto konsorciume nuk ofrojnë garanci se kontrata do të zbatohet nga shoqëria e avokatisë, pasi që pjesë të saj do të zbatoheshin nga shoqëritë tregtare që nuk kanë licencë të shoqërisë së avokatisë dhe nuk marrin përsipër të njëjtat detyrime ndaj palës së përfaqësuar siç parashihen me Ligjin për Avokatinë.

Pretendimi i tretë (III) :Sipas Nenit 26 Grupi i Operatorëve Ekonomik të Rregullores së Prokurimit Publik thuhet: "Një grup i OE nuk do të kërkohej të ketë formë të caktuar ligjore në mënyrë që të dorëzoj tenderin por AK rezervon të drejtën, nëse një kërkesë e tillë është e nevojshme për performancën e mirë të kontratës, të kërkoj nga grupi i përzgjedhur të ketë formë të tillë ligjore nëse kontrata i jepet një grupi të tillë si para-kusht të nënshkrimit të kontratës. Secili anëtarë i grupit duhet të përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, neni 65 i LPP-së. Në përputhje me këtë nen, secili anëtarë i grupit duhet të dorëzojë së bashku me tenderin e tyre Deklaratën nën Betim dhe në rast se autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënien e kontratës grupit në fjalë, secili anëtar i grupit duhet t'i sjellë vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë në përputhje me nenin 65 të LPP-së të specifikuar në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë."

Pretendimi i katërt (IV) :Operatori i rekomanduar për kontratë, referencën e arbitrazhit të dorëzuar nuk e ka në cilësinë e shoqërisë së avokatisë, por të avokatit individual, rrjedhimisht ky shërbim është ofruar para se operatori të jetë i regjistruar si shoqëri e avokatisë pranë Odës së Avokatëve të Kosovës. Arsyetimi i Zyrtarit përgjegjës të prokurimit se referenca vlen për të gjithë kompaninë është i paqëndrueshëm, pasi që koha kur ky shërbim është ofruar, kjo kompani nuk ka qenë shoqëri e avokatisë. Prandaj si e tillë nuk është dashur të pranohet nga ana e Autoritetit Kontraktues përkatësisht komisionit për vlerësimin e ofertave. Për më tepër referenca për shërbimet juridike gjyqësore, nuk mund të konsiderohet si punë e ngjashme, për shkak se është lëshuar nga një individ për një rast specifik penal dhe nuk ka të bëjë me shërbime të ngjashme, të tilla siç kërkohej në dosje të tenderit, ku një autoritet kontraktues kërkon shërbime komplekse me numër të madh seancash brenda një kohe të shkurtër. Autoriteti Kontraktues do të duhej të kishte parasysh kompleksitetin e shërbimeve juridike në vlerësimin e referencave për punë të ngjashme, gjë të cilën nuk e ka bërë dhe rrjedhimisht ka diskriminuar operatorët ekonomik në vlerësimin e ofertave. Në këtë mënyrë çmimet që ofrohen nga konsorciumet konkurrenente natyrisht se janë më të lira, kur shërbimet pjesërisht ofrohen nga avokat individual dhe jo shoqëri të avokatisë të cilat kanë shpenzime të operimit më të larta dhe standarde të cilësisë më të larta.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër SEJDIU & QERKINI SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me LPP të RK 04/l-042 Neni 1, Neni 6, Neni 52, Neni 56, Neni 59, Neni 60, Neni 65, Neni 66, Neni 69 dhe Neni Ne i kërkojmë OSHP të aprovohet si e bazuar ankesa, të detyrohet që në afat prej 10 ditësh, Autoriteti Kontraktues të informoj OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe të lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Pretendimi ankimor lidhet me kërkesën e dosjes së tenderit, e cila është formuluar si vijon: Shoqëria e avokatëve duhet të jetë në përputhje me nenin 27 par. 1 nënpar. 1.3 dhe nenin 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, për së paku një vit dhe të ketë të paktën katër avokatë të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Duhet të dorëzohet një kopje e vendimit nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe licencat për avokatët. Nëse shoqëria ka angazhuar avokatë shtesë për këtë aktivitet të prokurimit, atëherë duhet të dorëzohen edhe marrëveshjet për angazhimin e avokatëve nga Shoqëria. Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar, lideri i grupit të operatorëve ekonomikë është shoqëri avokatësh për më shumë se një vit dhe ka katër avokatë të licencuar nga OAK. Janë dorëzuar një kopje e vendimit të OAK për formimin e shoqërisë së avokatëve dhe licencat e katër avokatëve përkatës. Tre avokatë janë pjesë e "Pro Juris Law Firm" si lider i GOE, ndërsa një avokat është pjesë e "Tahiri & Partners" si anëtar i GOE, me marrëveshje për angazhim. Dosja e tenderit saktëson që nëse shoqëria ka angazhuar avokatë shtesë, duhet të dorëzohen marrëveshjet për angazhim të avokatëve. Tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar listën e katër avokatëve, duke përfshirë marrëveshjen për angazhim sipas dosjes së tenderit, duke plotësuar kështu kërkesën e dosjes. Pretendimi ankimor është konsideruar i pabazuar. Ankuesi nuk ka bashkangjitur në ofertë vendimin për themelimin e shoqërisë së avokatëve, por vetëm një vërtetim me nr. 340/21, që tregon dy avokatë. Ankuesi ka bashkangjitur licencat e disa avokatëve të tjerë, por jo kontratat e tyre të punës apo marrëveshjet për angazhim. Pretendimi tjetër ankimor lidhet me kërkesën e dosjes së tenderit, që kërkon dëshmi për përfundimin e së paku një shërbimi të ngjashëm të arbitrazhit vendor ose ndërkombëtar dhe një shërbimi të procedurave gjyqësore në gjykatat e Kosovës në tri vitet e fundit. Operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë një listë të kontratave të realizuara dhe të bashkëngjisin referencat ose çertifikatat për kryerjen e shërbimeve. Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar, është plotësuar lista e kontratave sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit, me referencat përkatëse për shërbimet e evidentuara. Është dorëzuar një referencë nga Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit, e cila nuk është lëshuar për një avokat individualisht, por për shoqërinë e avokatëve "Pro Juris Law Firm". Avokati për të cilin bëhet fjalë është drejtori menaxhues i shoqërisë "Pro Juris Law Firm". Pra, pretendimi ankimor është i pabazuar. Ankuesi ka dorëzuar një listë të kontratave sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit, duke evidentuar gjashtë kontrata, por vetëm tre referenca, një për kontratën e prokurimit dhe dy për shërbime të arbitrazhit. Njëra prej referencave të arbitrazhit është e datës 05.11.2020, pra jashtë periudhës së kërkuar. Ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë referencë për shërbime të procedurave gjyqësore në gjykatat e Kosovës, siç kërkohet në dosjen e tenderit. Përfundimisht, pretendimet e ankuesit janë konsideruar të pabazuara dhe kërkesa për rishqyrtim është refuzuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 13.05.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 397/2024, ndërsa me datë 18.05.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/397 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr

parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE SEJDIU & QERKINI SH.P.K eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/397 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Tenderi është publikuar më datën 01.02.2024 nga AK e Komunës së Prishtinës. Pas publikimit, një OE ka bërë pyetje sqaruese lidhur me kriteret e dosjes së tenderit. Në përgjigjet e AK-së të datës 09.02.2024 janë sqaruar kriteret lidhur me referencat, ku është kërkuar një referencë për përfaqësimin në gjykatë dhe një referencë për përfaqësimin në arbitrazh. Në bazë të përgjigjes, AK-ja ka vepruar drejt, në përputhje me ligjin e prokurimit dhe me afatet ligjore që parashihen në ligj për përgjigjet sqaruese. Gjithashtu, në bazë të ligjit, autoriteti kontraktues gëzon të drejtën të përcaktojë kriteret sipas nevojave që i duhen për një aktivitet të prokurimit. Në këtë rast, AK-ja ka sqaruar kërkesat e dosjes së tenderit, por nëse do të kishte rritur kërkesat, mund të cilësohej si kufizim i konkurrencës. Megjithatë, pas sqarimeve të kriterëve të dosjes së tenderit, unë si ekspert konstatoj se është hapur konkurrenca më shumë, që në bazë të ligjit të prokurimit cilësohet transparencë në përputhje me aktivitetin e prokurimit. Sa i përket këtij pretendimi ankimor lidhur me kriteret e dosjes, OE ankues në bazë të ligjit të prokurimit ka mundur të bëjë kërkesë për rishqyrtim 5 ditë para hapjes së ofertave lidhur me kriteret e dosjes së tenderit. Pretendimi i ngritur në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit është i pa afatshëm dhe i pabazuar.

Konstatimi i dytë (II): Në bazë të analizimit të ofertës së dorëzuar nga OE i rekomanduar, eksperti konstatoi se Grupi i OE i rekomanduar "Pro Juris Law Firm LLC dhe Tahiri & Partners ShPK", përkatësisht lideri i grupit, është i regjistruar si shoqëri e avokatisë në përputhje me Nenin 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë. Sa i përket pretendimit se partneri i konsorciumit nuk është i regjistruar si shoqëri e avokatisë në përputhje me Nenin 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, kjo kërkesë nuk ka qenë në dosjen e tenderit si kriter i përcaktuar nga AK-ja.

Kërkesa: Të jetë shoqëri e avokatëve konform nenit 27 par. 1 nënpar. 1.3 dhe nenit 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë për së paku një (1) vit me të paktën katër (4) avokatë me licencë nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

Dëshmia: Një kopje të vendimit nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe licencat për avokatët. Nëse shoqëria ka angazhuar avokatë shtesë për këtë aktivitet të prokurimit, atëherë duhet të dorëzohen edhe marrëveshjet për angazhimin e avokatëve nga shoqëria.

Gjithashtu, duke u bazuar në Udhëzuesin e Prokurimit Publik, nëse mungon licenca e konsorciumit në ofertë (në këtë rast lideri e ka), në bazë të Udhëzuesit mund të kërkohet licenca. Pra, sipas ligjit, udhëzuesit dhe rregullores, nuk ka nevojë që dy partnerët të jenë të regjistruar si shoqëri e avokatisë në Odën e Avokatëve të Kosovës. Eksperti sqaron se Autoriteti Kontraktues në përcaktimin e këtij kriteri dhe përshkrimin e çmimit nuk ka qenë i qartë gjatë përpilimit të kërkesave dhe dëshmive sa i përket dorëzimit të dëshmive që duhet ti plotësojë OE. Në bazë të

ligjit për prokurimin publik, autoritetet duhet të paraqesin kërkesa të qarta. Kriteret kufizuese, diskriminuese, kritere të larta që sjellin vështirësi të mëdha për operatorët e interesuar, kriteret që kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ose të paqarta nuk janë të lejuara përmes ligjit të prokurimit, sikurse në rastin e këtij aktiviteti të prokurimit. Gjithashtu, sipas nenit 72 të LPP-së, AK-ja ka të drejtë të kërkojë informata shtesë duke plotësuar apo qartësuar certifikata apo dokumente të caktuara në pajtim me nenet 65-71 të ligjit për prokurimin publik. Duke marrë parasysh të vërtetohen licencat e kërkuara, këto licenca të avokatëve janë të bashkangjitura në ofertë dhe sipas nenit 70 të LPP-së mund të hyjnë në kategorinë e standardeve për sigurimin e cilësisë. Pra, sipas nenit 72, AK-ja ka të drejtë të kërkojë sqarime shtesë për këto dokumente, gjithmonë duke u siguruar që data e lëshimit të tyre është brenda periudhave të parapara ligjore. Sa i përket pretendimit lidhur me licencat e avokatëve, AK-ja është kompetente për të vërtetuar nëse këto dokumente janë sipas ligjeve në fuqi për avokatinë. Në bazë të ligjit të prokurimit, kërkesat - kapaciteti teknik dhe profesional 9.1 dhe 9.2 janë kërkesa që ju referohen nenit 69 të LPP-së. Në bazë të këtij neni, mund ti plotësojë vetëm njëri partner i konsorciumit. Pra, çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të grupit. Neni 66.2 thotë: "Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betim se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit." Në përputhje me dispozitat e lartcituara, është e drejtë e çdo operatori ekonomik i cili nuk mund ti përmbushë si i vetëm kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, të mbështetet në kapacitetet e partnerit në konsorcium apo të marrë pjesë në grup të operatorëve ekonomikë (konsorcium). Operatori ekonomik i cili mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ndërsa në rastin e grupit të operatorëve ekonomikë, grupi është individualisht dhe bashkërisht përgjegjës për ekzekutimin e kontratës. Sa i përket kriterit të kërkuar për 4 avokatë me licencë, partnerët në konsorcium e plotësojnë kushtin e kërkuar me Nenin 30 të Ligjit nr. 04/L-193 për 4 avokatë të licencuar: Driton Muharremi, Arber Krasniqi, Agnez Furra dhe Ahmet Tahiri. Sa i përket pretendimit lidhur me kushtet e konsorciumit që kanë aplikuar në konsorcium me operatorë që nuk janë shoqëri të avokatëve, në bazë të nenit 71 të ligjit, grupi i OE të rekomanduar ka dorëzuar deklaratat të nënshkruara nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Në këtë rast, asnjë anëtar – avokat nuk merr pjesë në disa grupe që të konsiderohet grupi përkatës si i papërshtatshëm. Eksperti konstaton se, në bazë të marrëveshjes së konsorciumit, të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe, nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë.

Në këtë pikë konsiderohet që pretendimi nuk është i bazuar.

Konstatimi i tretë (III) : Sa i përket këtij pretendimi, para publikimit B58, njoftimi mbi vendimin e AK-së duhet ti sjellin dy partnerët në konsorcium vërtetimet e përshtatshme të cilat kërkojnë nga neni 65 i LPP-së. Në bazë të fakteve në sistemin e-prokurim, konstatohet se iu është dërguar kërkesa që t'i sjellin vërtetimet. Me ofertë, kompania "Pro Juris" ka dorëzuar vërtetimin e ATK-së të datës 06.03.2024 për tremujorin e parë, ndërsa "Tahiri Partners" e ka

dorëzuar më 11.03.2024 dhe vërtetimet e gjykatës. Eksperti shqyrtues konstaton se partnerët në konsorcium posedojnë dhe plotësojnë kushtin e kërkuar në dosjen e tenderit sipas nenit 65 të LPP-së. Në bazë të fakteve të konstatuara, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Konstatimi i katërt (IV) : Sipas kërkesës së dosjes së tenderit, operatori ekonomik duhet të plotësojë një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit. Kjo përfshin saktësimin e titullit të kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit, si dhe përfituesin. Listës duhet ti bashkëngjiten referencat ose çertifikatat për kryerjen e shërbimeve. Në bazë të listës së dorëzuar me ofertë dhe referencave të bashkëngjitura, Grupi i OE të rekomanduar për kontratë e plotëson kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor nga kompania ankuese "SEJDIU & QERKINI" SH.P.K., se referenca e arbitrazhit është lëshuar para se të jenë pjesë e shoqërisë së avokatisë partnerët e rekomanduar për kontratë, kjo çështje nuk është me rëndësi nëse referenca është lëshuar para apo pas. E rëndësishme është që referenca të jetë brenda tri viteve, siç është kërkesa e dosjes. Në bazë të fakteve, referenca është e vitit 2022 dhe 2023, dhe eksperti konstaton se partnerët në konsorcium të rekomanduar e plotësojnë kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit. Gjithashtu, pretendimi se nuk duhet të pranohen referencat nga Autoriteti Kontraktues, pasi duhej të kishte parasysh kompleksitetin e shërbimeve juridike në vlerësimin e referencave për punë të ngjashme, është i pabazuar. Në dosjen e tenderit, kompleksiteti i shërbimeve është ndarë në kategori të vogla deri 10.000 euro për përshkrimin e çmimeve, kështu që nuk mund të përjashtohen rastet apo referencat e vogla. Megjithatë, kriteret në dosjen e tenderit nuk janë ndarë sipas kompleksitetit, duke bërë që pretendimi të jetë i pabazuar. Në bazë të nenit 69 të LPP-së, çdo OE mund të dëshmojë për autoritetin kontraktues se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës. Nën të njëjtat kushte, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në referenca të individëve të tjerë për të plotësuar kushtet e kërkuara të dosjes së tenderit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit me numër të prokurimit 616-24-599-2-1-1”.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " SEJDIU & QERKINI " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: